


Udhërrëfyes

PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN
E KËSHILLAVE VENDORË
TË SIGURISË PUBLIKE
(KVSP)



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim


**UDHËRRËFYES
PËR NGRITJEN
DHE FUNKSIONIMIN
E KËSHILLAVE VENDORË
TË SIGURISË PUBLIKE
(KVSP)**

Përgatitur nga: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Janar 2023

Udhërrëfytyesi “Për ngritjen dhe funksionimin e Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike (KSVP)” u hartua në kuadër të Programit “Riintegrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria”, i cili po zbatohet në Shqipëri nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në bashkëpunim me Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve si dhe me Qendrën e Gruas për Zhvillim dhe Kulturë, koordinuar në nivel kombëtar nga Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, me financim të Fondit Global të Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë së Komunitetit (GCERF).

Pikëpamjet dhe informacionet e dhëna në këtë dokument janë vetëm të autorëve dhe nuk shprehin domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e donatorit.



DESIGN & LAYOUT:

Eduart Cani

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
KUJT I DREJTOHET KY UDHËRRËFYES?	6
MËSIMET TË NXJERRA	7
PRAKTIKA TË MIRA	8
NJË MODEL I RI	10
NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE PRANË NJVV	12
PLANI VENDOR SHUMAKTORIAL	17
PRAKTIKA TË MIRA: PLANI VENDOR SHUMAKTORIAL	18
PARIMET DHE VLERAT NË TË CILAT MBËSHTETET KËSHILLI VENDOR I SIGURISË PUBLIKE (KVSP)	20
NDIKIMI I MODELIT TË KVSP-VE NË INSTITUCIONET PUBLIKE DHE JO-PUBLIKE	21
SHTOJCA 1. RREGULLORE E BASHKISË ELBASAN “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE”	25
SHTOJCA 2: QENDRA E KOORDINIMIT KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM NË SHQIPËRI	32



HYRJJE

Këshilli Vendor i Sigurisë Publike (KVSP) është një mekanizëm këshillimor i cili ngrihet në çdo njësi të vetëqeverisjes vendore me qëllim hartimin e politikave dhe plan-veprimeve gjithëpërfshirëse që kontribuojnë në rritjen e sigurisë publike në nivel vendor. Praktika e deritanishme ka treguar se zbatimi efektiv i këtij mekanizmi nga institucionet vendore ka qënë një sfidë e vazhdueshme. Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021 – 2026¹ konstaton mungesën e zbatimit efektiv dhe praktik të këtij instrumenti i cili nuk ka dhënë efektet e pritshme në lidhje me çështjet e sigurisë vendore dhe të planifikimit të përbashkët të burimeve në dispozicion. Strategjia evidenton nevojën e konsolidimit të metodologjisë dhe funksionimit të KVSP-ve, përmes hartimit të një modeli të unifikuar që duhet të gjejë zbatim e tij në të gjitha bashkitë e vendit deri në vitin 2024.

Përmes këtij dokumenti, IDM prezanton një model për funksionimin dhe fuqizimin e KVSP-ve, si dhe parashtron mundësitë e replikimit të tij në të gjitha bashkitë e vendit. Udhërrëfyeti adreson metodologjinë e punës së KSVP-së, duke detajuar të gjitha hapat institucionale dhe proceduriale të nevojshme për ngritjen dhe mirëfunksionimin e tij pranë njësive të vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu, udhërrëfyeti përmban edhe praktika të mira dhe mbështetet në mësimet të nxjerra nga përvoja e funksionimit të KVSP-ve në Shqipëri, si dhe në vende të tjera të rajonit. Përmes promovimit të një qasjeje shumaktoriale dhe ndërinstitutionale, modeli garanton gjithëpërfshirje, transparencë dhe angazhim qytetar në identifikimin dhe ndjekjen e prioriteteve vendore, përfshirë çështjet e sigurisë publike.

1 Vendim Nr. 1139, datë 24.12.2020, 'Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026 dhe Planit të Veprimit 2021-2023. <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2021/01/STRATEGJIA-ND%C3%8BRSEKTORIALE-E-SIGURIS%C3%8B-N%C3%8B-KOMUNITET-2021%E2%80%932026-DHE-T%C3%8B-PLANI-I-VEPRIMIT-2021%E2%80%932023.docx>

KUJT I DREJTOHET KY UDHËRRËFYES?

Udhërrëfyesi “Për ngritjen dhe funksionimin e Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike” i drejtohet çdo aktori publik dhe jo publik në realizimin e misionit të vet në ruajtjen e rendit, sigurisë publike, parandalimit dhe luftës ndaj krimit si dhe zhvillimit të komuniteteve vendore të qëndrueshme. Udhërrëfyesi shërben si një

instrument për forcimin e kohezionit ndërmjet institucioneve në marrjen dhe ndarjen e përgjegjësive si dhe në përballjen me sfidat e sigurisë në nivel vendor. Ai i drejtohet të gjithë zyrtarëve vendorë të institucioneve publike të përfshirë në veprimtarinë e KVSP-ve si edhe aktorëve të tjerë të interesuar në nivel vendor si:



KRYETARIT TË BASHKISË për konceptimin e drejtë të rolit të tij si dhe të strukturave të ndryshme të bashkisë në realizimin e misionit të tyre në ndërveprim dhe ndarje përgjegjësish me institucionet e tjera, shoqërinë civile dhe qytetarët për përmirësimin e shërbimeve të sigurisë publike.



SHEFIT TË KOMISARIATIT DHE STRUKTURAVE NË VARËSI të tij në nivel vendor për ta vlerësuar ndryshe policimin në partneritet të pandashëm me aktorët e tjerë vendorë.



INSTITUCIONIT TË PROKURORISË SË RRETHIT që në mënyrë proaktive të zhvillojë komunikime publike me aktorët e tjerë duke përfshirë shkollat dhe shoqërinë civile në edukimin ligjor të qytetarëve.



ÇDO ANËTARI TË KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE dhe ÇDO ANËTARI TË KËSHILLIT BASHKIAK për të ndërtuar një vizion të qartë se rendi dhe siguria publike janë një përgjegjësi ndërsektoriale dhe e përhershme.

MËSIMETË NXJERRA

Gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit në vende të ndryshme të rajonit është nxitur me pritshmëri të lartë procesi i ngritjes së KVSP-ve. Ashtu si në vendet e tjera të rajonit, kryesisht në Kosovë² dhe Serbi, edhe në vendin tonë, vlerësime të pavarura e konsiderojnë përvojën e KVSP-ve si një strukturë formale që kufizohet në formatin e një konsultimi të kufizuar dhe të mbyllur.³ Këto studime theksojnë mungesën e përfshirjes së qytetarëve në aktivitetin e KVSP-ve si një nga faktorët kryesor për karakterin formal të kësaj strukture. Në një studim të IDM-së⁴ evidentohet se policia e shtetit ka hasur vështirësi në

krijimin e partneriteteve të qëndrueshme me aktorët vendorë në hartimin e strategjive vendore të policimit. Pavarësisht se Policia e Shtetit dhe institucionet e qeverisjes vendore kanë bashkëpunuar në mënyrë formale dhe joformale, ky ndërveprim nuk ka rezultuar në angazhimin e njësive të qeverisjes vendore në hartimin dhe zbatimin e strategjive si dhe në krijimin e partneriteteve. Për më tepër, Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë Publike⁵ e cilëson implementimin efektiv dhe praktik të instrumentit si një dështim.

- 2 Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Vlerësimi i Mbikëqyrjes Demokratike dhe Mekanizmave të Qeverisjes së Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi, 2010, fq. 4, [http://www.qkss.org/repository/docs/Vler%C3%ABsimi_i_Mbik%C3%ABqyrjes_Demokratike_dhe_Mekanizmavet%C3%AB_Qeverisjes_s%C3%AB_K%C3%ABshillave_Komunale_p%C3%ABr_Siguri_n%C3%AB_Bashk%C3%ABsi_\(alb_eng_srb\)_809361.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Vler%C3%ABsimi_i_Mbik%C3%ABqyrjes_Demokratike_dhe_Mekanizmavet%C3%AB_Qeverisjes_s%C3%AB_K%C3%ABshillave_Komunale_p%C3%ABr_Siguri_n%C3%AB_Bashk%C3%ABsi_(alb_eng_srb)_809361.pdf)
- 3 Qendra e Beogradit për Politikën e Sigurisë. "Partneritet për Komunitete të Sigurta në Serbi (Partnership for Safe Communities in Serbia)" 2014, http://www.bezbednost.org/upload/document/partnership_for_safe_communities.pdf. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Vlerësimi i Mbikëqyrjes Demokratike dhe Mekanizmave të Qeverisjes së Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi, 2010, fq. 4, [http://www.qkss.org/repository/docs/Vler%C3%ABsimi_i_Mbik%C3%ABqyrjes_Demokratike_dhe_Mekanizmavet%C3%AB_Qeverisjes_s%C3%AB_K%C3%ABshillave_Komunale_p%C3%ABr_Siguri_n%C3%AB_Bashk%C3%ABsi_\(alb_eng_srb\)_809361.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Vler%C3%ABsimi_i_Mbik%C3%ABqyrjes_Demokratike_dhe_Mekanizmavet%C3%AB_Qeverisjes_s%C3%AB_K%C3%ABshillave_Komunale_p%C3%ABr_Siguri_n%C3%AB_Bashk%C3%ABsi_(alb_eng_srb)_809361.pdf)
- 4 Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Vlerësimi i strategjisë të Policimit në Komunitet dhe i bashkëpunimit të Policisë së Shtetit me Institucionet e qeverisjes vendore, 2015, fq. 5, http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2016/05/Policimi-n%C3%AB-komunitet-n%C3%ABshqip%C3%ABri-2007_Shqip.pdf.
- 5 Vendim Nr. 1139, datë 24.12.2020, 'Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026 dhe Planit të Veprimtimit 2021-2023'.

PRAKTIKA TË MIRA

Eksperienca e deritanishme ka treguar se një qasje e integruar shumaktoriale në nivel vendor do të ishte efektive jo vetëm në adresimin e kërcënimeve tradicionale që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit dhe sigurinë publike, por edhe më tej në parandalimin e fenomeneve të tjera të tilla si radikalizimi dhe ekstremizmi i dhunshëm. Në këtë kuadër, IDM ka iniciuar një udhërrëfyes me qasje më gjithëpërfshirëse të luftës dhe parandalimit të krimit në nivel vendor e cila mbështetet në një model ciklik ndërveprimi midis bashkisë, policisë dhe prokurorisë.

Modeli i “trekëndëshit institucional” të ndërveprimit bashki-polici-prokurori orienton përmes një qasje gjithëpërfshirëse plane veprimi dhe masa konkrete për parandalimin e krimit dhe sigurisë publike. Ky model është pilotuar në 20 bashki të vendit si metodologjia më efikase për mirëfunksionimin e KVSP-ve.

Gjatë periudhës 2018-2019, IDM pilotoi me sukses modelin e “trekëndëshit” të takimeve konsultuese të hapura për parandalimin e krimit dhe sigurisë publike në 20 bashki të vendit. Nën drejtimin e Kryetarit të Bashkisë, Shefit të Komisarariatit dhe Prokurorit në këto konsultime

publike u përfshinë edhe përfaqësues të komuniteteve vendore si: kryetarë fshatrash, ndërlidhës komunitarë, përfaqësues të institucioneve në nivel vendor, biznesit, shoqërisë civile, komuniteteve fetare, medias e qytetarëve të ndryshëm të interesuar, shkollat dhe të rinjtë. Në këndvështrimin e punës së Këshillit Vendor të Sigurisë Publike këto takime të hapura publike garantojnë:

- » Pjesëmarrjen dhe kontributin e qytetarëve në proceset konsultuese që lidhen me rendin dhe sigurinë publike;
- » Transparencën e agjendës vendore mbi sigurinë, e cila buron nga qytetarët në përputhje me problematikat dhe kërcënimet e sigurisë në komunitet;
- » Zhvillimin, konsolidimin dhe promovimin e një fryme dhe përvoje partneriteti horizontal vendor që frymëzohet nga modeli i “trekëndëshit”;
- » Promovimin e kulturës së bashkëpunimit dhe ndarjes së përgjegjësiive ndërmjet institucioneve të ndryshme në adresimin e sfidave të sigurisë publike;
- » Qëndrueshmërinë e rezultateve në

parandalimin dhe luftën ndaj krimit, duke marrë në konsideratë që zbatimi i planit shumaktorial monitorohet nga vetë institucionet e “trekëndëshit”; Kjo praktikë e shndërron Këshillin Vendor të Sigurisë Publike në “një qendër gjithëpërfshirëse të vlerësimit të prioriteteve dhe të ndërtimit të politikave për sigurinë vendore”.

Një rast specifik i kësaj praktike novatore i adresohet Bashkisë së Elbasanit, e cila në vitin 2016 krijoi KVSP-në me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së, Tiranë, dhe programit suedez të policimit në komunitet.⁶ Gjatë periudhës 2018-2019, IDM në bashkëpunim me Kryetarin e Bashkisë, drejtuesit vendore të policisë dhe Drejtuesin e Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Elbasan⁷ zhvilluan një sërë takimesh të hapura konsultative për ndërtimin e një agjende vendore të sigurisë përmes komunikimit me qytetarët dhe

llogaridhënien publike.⁸ Këto takime konsultative të hapura “të trekëndëshit” u lidhën organikisht me veprimtarinë e KVSP-së duke krijuar premisa për t’i dhënë një karakter konkret dhe të preکشëm bashkëpunimit ndërinstytucional në luftën ndaj krimit. Përfaqësuesit e institucioneve të “trekëndëshit” i analizuan dhe shndërruan kërcënimet dhe problematikat e ndryshme të artikuluara nga qytetarët në takimet e hapura në objektiva pune të një plani shumaktorial vendor.

Mbështetur në këtë përvojë, KVSP-ja e Elbasanit rikonceptoi rregulloren “Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike” e cila u miratua nga Këshilli Bashkiak me vendim nr.2, datë 04.03.2022.⁹

- 6 Programi "Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri" (SCPA) financohet nga Qeveria Suedeze nëpërmjet Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Sida) dhe zbatohet në Shqipëri nga kompania FCG Sweden.
- 7 Trekëndëshi i bashkëdrejtimit të KVSP-së përfaqësohet nga Kryetari i Bashkisë, Drejtuesi i Drejtorisë Vendore të Policisë dhe Prokurori i Rrethit Gjyqësor përkatës.
- 8 Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Buletini Nr.6 "Integritet- Llogaridhënie- Partneritet", 2020. https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/IDM_Buletin_6_Mars2020-2.pdf
- 9 Shih: <https://idmalbania.org/sq/bashkia-elbasan-miraton-rregulloren-e-re-dhe-planin-nderinstytucional-per-organizimin-dhe-funksionimin-e-keshillit-vendor-per-sigurine-publike/>

**NJË
MODEL
I RI**



NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE PRANË NJVV

Këshilli Vendor i Sigurisë Publike ngrihet në nivel të njësisë së vetëqeverisjes vendore (NJVV) dhe në përbërje të tij janë krerët e institucioneve publike të trekëndëshit (Bashki-Polici-Prokurori) si dhe përfaqësues të aktorëve të tjerë publikë dhe jo publikë në nivel vendor.

“trekëndëshit”. Pavarësisht se në përbërje të KVSP-ve janë përfaqësues të institucioneve të ndryshme, në qendër të veprimtarisë të një KSVP-je qëndron qytetari, sfidat dhe kërcënimet e sigurisë në nivel komunitar.

KVSP është institucioni më gjithëpërfshirës në nivel vendor i cili mbështetet në partneritetin horizontal të institucioneve publike dhe jo publike. Si i tillë, KVSP shndërrohet në një qendër të politikave të sigurisë në nivel vendor.

Si rregull, procesi për ngritjen dhe funksionimin e KVSP-ve drejtohet nga kryetari i bashkisë në bashkërendim me institucionet ligjzbatuese si Policia e Shtetit dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, të njohur ndryshe si institucionet e

KSVP-ja përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:¹⁰

- a) Kryetari i Bashkisë;
- b) Kryetari i Këshillit Bashkiak;
- c) Drejtues i Komisarariatit të Policisë;
- d) Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor në juridiksionin e së cilës përfshihet bashkia;
- e) Anëtar i Këshillit Bashkiak që siguron përfaqësimin e çdo partie politike në Këshillin bashkiak;

10 Neni 4 i Rregullores tip për ngritjen dhe funksionimin e KVSP.

- f) Drejtues i Zyrës Vendore Arsimore;
- g) Drejtues i Drejtorisë Vendore të Shëndetit Publik;
- h) Përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Vendor Social Shtetëror;
- i) Nga një përfaqësues i komuniteteve fetare në nivel vendor;
- j) Përfaqësues të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në nivel vendor;
- k) Përfaqësues të shoqërisë civile (organizata rinore, organizata e grave, media vendore, biznese, shoqata të pakicave kombëtare, etj.);
- l) Drejtues i Emergjencave Civile në bashki dhe qark;
- m) Drejtues i Shërbimit Social në bashki;
- n) Përfaqësues nga njësia për mbrojtjen e fëmijëve dhe kundër dhunës në familje;
- o) Drejtues të institucioneve arsimore në bashki.

Në mbledhjet e KVSP-së mund të ftohen të marrin pjesë edhe:

- a) Prefekti i Qarkut
- b) Kryetari i Gjykatës së juridiksionit të përgjithshëm;
- c) Përfaqësues të institucioneve publike të

ndryshme në nivel vendor apo të grupeve të interesit, në varësi të tematikës së mbledhjes.

KVSP-ja si rregull duhet të mbledhet të paktën 2 herë në vit, ose çdo herë që ka një agjendë të rëndësishme për të diskutuar. Mbledhja e shpeshtë e KVSP-së mbart riskun e zhvlerësimit të tij.

Është përgjegjësi e drejtuesve të “treëndëshit” të edukojnë një kulturë pune të hapur dhe bashkëpunuese ndërinstitucionale në zbatim të përgjegjësiave të tyre.

Këshilli i Vendor i Sigurisë Publike kryesohet nga Kryetari i Bashkisë, i cili mbështetet nga dy struktura specifike në mirëfunksionimin e mekanizmit:

- » **Sekretariati Koordinues Ndërinstitucional (SKN)**, në rolin e strukturës përgjegjëse për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit

shumaktorial vendor¹¹;

- » **Sekretari teknik**, i cili përfaqësohet nga një punonjës i bashkisë, i cili është përgjegjës për dokumentimin dhe arkivimin e veprimtarinë së KVSP-së¹².

Sekretariati Koordinues Ndërinstitucional përbëhet nga tre anëtarë, përkatësisht: një përfaqësues i Bashkisë, Policisë dhe Prokurorisë të cilët caktohen nominalisht nga titullarët e tyre.¹³ Është shumë e rëndësishme që drejtuesit e “trekëndëshit” të caktojnë si përfaqësues të institucionit në Sekretariatit Koordinues SNK individë që gëzojnë autoritet dhe aftësi për të kryer këtë funksion.

Sekretariati Koordinues Ndërinstitucional merr pjesë në takimet e hapura dhe mbledhjet e KVSP-së. Pjesë e përgjegjësisve dhe detyrave të këtij sekretariati është dakordësimi i agjendës së takimeve konsultuese publike si dhe të mbledhjeve të KVSP-së; prioritizimi i kërcënimeve të artikuluar në mbledhjen e hapur konsultuese të “trekëndëshit”; planifikimi i aktiviteteve konkrete sipas një analize mbi përgjegjësitë e institucioneve duke përcaktuar afatet, institucionet përgjegjëse dhe indikatorët e matshëm për zbatimin e planit vendor

shumaktorial. Plani shumaktorial diskutohet në mbledhjen e radhës së KVSP-së, ku edhe miratohet.

Sekretariati koordinues ndërinstitucional (SKN) është përgjegjës për ecurinë e zbatimit të planit vendor shumaktorial. SKN mbledhet periodikisht (së paku 1 herë në muaj) për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve dhe masave të planit dhe raporton pas çdo mbledhjeje tek drejtuesit e institucioneve përkatëse.


Takimet e hapura konsultative, të cilat mbahen 2 herë në vit, shërbejnë për konsultimin e strukturave teknike me komunitetet, fuqizojnë llogaridhënien dhe përditësojnë prioritetet vendore të sigurisë. Çdo takim i tillë shoqërohet në vijim nga mbledhja e radhës e KVSP-së, në të cilën miratohen ndryshimet përkatëse në planin shumaktorial vendor.

11 Neni 8/2 dhe 9 i Rregullores tip për ngritjen dhe funksionimin e KVSP

12 Neni 10, idem

13 Neni 9 i rregullores tip për ngritjen dhe funksionimin e KVSP

Figura 1. Skema e procesit vjetor (ciklik) të aktivitetit të KVSP-së



Neni 7 pika 3 e rregullores i jep mundësi kryetarit të KVSP-së të thërrasë takime më të ngushta ekspertësh për çështje të veçanta. Sipas problematikës këto takime janë edhe ndërinstucionale. Për shembull: Në një lagje të qytetit apo në një fshat ka familje/apo nëna me fëmijë që janë kthyer nga zonat e konflikteve të armatosura. Specifikisht në këtë rast mund të funksionojë një skuadër sipas situatës me pjesëmarrjen e punonjësit social, edukatorit, punonjësit shëndetësor, OJF-së nëse ka dhe punonjësit të policisë së shtetit. Ekipi që mund të konsiderohet një task force merret në mënyrë të vazhdueshme me trajtimin e rastit dhe riintegrimin e individëve në shoqëri.

Neni 7 pika 2 e rregullores të KVSP-ve mbështetet edhe tek VKM 578/2018, " Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes" dhe operon në nivel vendor për identifikimin, menaxhimin dhe referimin e rasteve në nivel vendor.

Kuadri ligjor (Neni 52 i Ligjit nr. 18/2017) parashikon se në çdo bashki dhe njësi

administrative me mbi 3000 fëmijë ngrihet ad-hoc Grupi Teknik Ndërsektorial (GTN) për mbrojtjen e fëmijës, me pjesëmarrje të aktorëve kryesorë të arsimit, shëndetësisë, policisë, shërbimeve sociale dhe aktorë të tjerë, të cilët identifikohen të rëndësishëm për rastin që trajtohet.

GTN-ja thirret nga NJMF-ja sa herë është e nevojshme për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik. Qëllimi kryesor i të gjithë anëtarëve të këtij grupi është mbledhja së bashku për të caktuar masat e nevojshme që duhet të ndërmerren si dhe personat apo institucionet përgjegjëse për realizimin e tyre, për të siguruar mbrojtje të përshtatshme për fëmijën në rrezik. GTN-ja ka shumë mekanizma dhe formate që përdor për identifikim, vlerësim dhe referim rastesh apo ofrim shërbimesh (nënat dhe familjet përfitojnë automatikisht nga fëmijët). Përpos kësaj, bashkitë kanë edhe MOU me institucionet e tjera vendore për të garantuar pjesëmarrjen institucionale të përfaqësuesve në GTN-në dhe ofrimin e koordinuar të shërbimeve.

PLANI VENDOR SHUMAKTORIAL

Fokusi i veprimtarisë së KVSP-së konsiston në miratimin e një plani shumaktorial për parandalimin e krimit. Metodologjia për zhvillimin e këtij plani parashikohet në nenin 8 të rregullores tip “Për ngritjen dhe funksionimin e KVSP”, si më poshtë :

- 1. Plani vjetor shumaktorial** buron nga komunikimi i hapur publik i drejtuesve të Bashkisë, Policisë dhe Prokurorisë, me grupe interesi dhe qytetarë (të tillë si drejtuesit e shkollave të ndryshme, prindërve, qeveritë e nxënësve, kryetarët e fshatrave apo ndërlidhësit komunitarë, përfaqësues të bizneseve vendore, shoqërisë civile dhe medias).
- 2. Sekretariati Koordinues Ndërsektorial (SNK)** (neni 9) vlerëson intensitetin e risqeve (të lartë, të moderuar dhe të ulët), orienton llojin e aktivitetit dhe institucionet përgjegjëse. Prioritetet dhe intensiteti i risqeve të sigurisë të prezantuara nga qytetarët përbëjnë boshtin e planit shumaktorial vendor.
- 3. Plani i veprimit** përmban një kalendar aktivitetesh dhe afatesh për organizimin e tyre të cilat synojnë adresimin e risqeve të vlerësuara.
- 4. Plani shumaktorial vendor** diskutohet dhe miratohet në mbledhjen e radhës të KVSP-së.
- 5. Monitorimi i planit vjetor shumaktorial** realizohet nga drejtues të Bashkisë, Policisë dhe Prokurorisë, përmes takimeve konsultuese të hapura me komunitetin një herë në 6 muaj. Në këto takime publike konsultuese analizohet ecuria e zbatimit të planit shumaktorial dhe identifikohen nevojat për përditësimin e tij. Rishikimi i planit vjetor shumaktorial me objektiva apo masa të reja mbështetur në nevojat e identifikuar nga mbledhja e KVSP-së.
- 6.** Një format tip i raportit të monitorimit të zbatimit të planit shumaktorial vendor hartohet nga sekretariati teknik dhe ai koordinues dhe miratohet nga kryetari i KVSP-së.

Çdo institucion publik pjesë e KVSP-ve publikon në faqen zyrtare të internetit të institucionit respektiv planin shumaktorial vendor.

PRAKTIKA TË MIRA: PLANI VENDOR SHUMAKTORIAL

Tabela nr.1 Plani i përbashkët ndërinstitucional për parandalimin e krimit në Bashkinë Elbasan

Nr.	Problematika e identifikuar	Prioriteti • i lartë • i moderuar • i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për adresimin e problematikës	Institucioni përgjegjës	Afati
1.2	Përballja me dukurinë e “kulturës së heshtjes” nga institucionet e “trekëndëshit”	Prioritet i moderuar	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rritja e komunikimit dhe transparencës të çdo institucioni në mënyrë periodike me qytetarët; 2. Mbajtja e takimeve periodike me OJF-të dhe grupe të tjera të interesit nga institucionet e “trekëndëshit”; 3. Rritja e komunikimit dhe partneritetit të policisë me qytetarët. 	Drejtoria e Policisë/ Komisarati i Policisë Elbasan Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Bashkia Elbasan	Çdo 2 muaj
1.4	Konsumi i lëndëve narkotike, alkoolit, dhe duhanit nga të rinjtë (Gjatë vitit 2021, janë konstatuar 63 raste të prodhimit dhe shpërndarjes së lëndëve narkotike, me 102 autorë të evidentuar si të përfshirë në këto vepra penale nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan)	Prioritet i lartë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillimi i orëve edukative ligjore nga Prokuroria për të rinjtë; 2. Përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit midis policisë, shkollës, nxënësve dhe prindërve; 3. Konsultimi me liderët e komuniteteve, dhe grupet e interesit. 	Drejtoria e Policisë/ Komisarati i Policisë Elbasan Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Bashkia Elbasan Drejtoria Arsimore	6 Mujori i pare

Nr.	Problematika e identifikuar	Prioriteti • i lartë • i moderuar • i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për adresimin e problematikës	Institucioni përgjegjës	Afati
1.5	Dhuna në familje (Për vitin 2021 janë evidentuar 56 raste të dhunës në familje në këtë bashki/ 7 vepra penale më pak se në vitin 2020, statistika nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan) (Përditësuar nga takimit i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, mbajtur më datë 03 Shkurt 2022)	Prioritet i lartë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Konsultimi midis bashkisë dhe OJF-ve për të identifikuar problematikat/fushat prioritare; 2. Nxitja e partneritetit midis policisë dhe strukturave komunitare/ ndërlidhësit komunitar; 3. Drejtoria vendore e Policisë Elbasan do të ndërmarrë krijimin e një databaze; 4. Vendosija e numrave të kontaktit me viktimat e dhunës dhe përfaqësues të Komisarariatit të Policisë. 	Drejtoria e Policisë/ Komisarriati i Policisë Elbasan Prokuroria e Rrethit Gjiqësor Bashkia Elbasan OJF	Gjatë gjithë vitit
1.7	Zonat e "nxehta"/ hotspotet për përdoruesit dhe shpërndarësit e drogës apo të krimit (Përditësuar nga takimit i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, mbajtur më datë 03 Shkurt 2022)	Prioritet i lartë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Identifikimi i zonave të nxehta dhe publikimi i tyre; 2. Përmirësimi i një sistemi vëzhgues të kamerave në qytet; 3. Evidentimi individual i frekuentuesve të këtyre zonave dhe bashkëpunimi ndërinstitucional për të ulur intensitetin e përfshirjes individuale në grupe; 4. Ndjekja në vazhdimësi të dinamikës së lëvizjes dhe ndryshimit të zonave të "nxehta". 	Drejtoria e Policisë/ Komisarriati i Policisë Elbasan Prokuroria e Rrethit Gjiqësor Bashkia Elbasan Përfaqësues të komunitetit OJF	6 Mujori i pare

PARIMET DHE VLERAT NË TË CILAT MBËSHTETET KËSHILLI VENDOR I SIGURISË PUBLIKE (KVSP)

Procesi që ndjek funksionimin e KVSP-ve në nivel bashkie, reflekton dinamikat dhe veçoritë e çdo njësie të vetëqeverisjes vendore. Si rrjedhojë, modeli që ofrohet përmes këtij dokumenti, mbështetet në parimet e gjithëpërfshirjes, partneritetit, konsultimit dhe llogaridhënies si parime që sigurojnë suksesin dhe qëndrueshmërinë e KVSP-ve. Në këto parime përfshihen:

- » Gjithëpërfshirja e institucioneve të “trekëndëshit” me aktorët vendorë publikë dhe jo-publikë institucionalizon frymën e partneritetit horizontal të gjithë aktorëve.
- » Konsultimi dhe ndarja e përgjegjësive siguron qëndrimin aktiv të qytetarëve në përpjekjet vendore për luftën ndaj krimit.
- » Rritja e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve dhe administratës vendore si garanci për zbatimin e ligjshmërisë në nivel vendor.
- » Rritja e transparencës dhe komunikimit publik në punën e institucioneve vendore siguron besueshmërinë e publikut dhe bashkëpunimin e tyre.

Figura 2: Vlerat që burojnë nga veprimtaria e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike



NDIKIMI I MODELIT TË KVSP-VE NË INSTITUCIONET PUBLIKE DHE JO-PUBLIKE

Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet thekson se siguria publike nuk do të jetë më kompetencë vetëm e Policisë së Shtetit, por ky koncept tashmë do të jetë më demokratik dhe në rrafshin horizontal, duke mbledhur bashkë të gjithë aktorët në nivel qendror dhe vendor¹⁴, të tilla si qeverisjen vendore, Policinë e Shtetit, qytetarët dhe komunitet, institucionet e tjera joqeveritare, forumet qytetare, bizneset, institucionet fetare, mediat, si dhe aktorë të tjerë. Siç është shpjeguar në këtë udhërrëfyes, ky model i organizimit dhe funksionimit të KVSP-ve është në harmoni të plotë me këto objektiva, duke nxitur një kulturë të re gjithëpërfshirëse për punën e rendit dhe sigurisë publike.

Kjo qasje i jep bashkisë rolin e munguar në qeverisjen e sigurisë dhe në përmirësimin e shërbimeve në fushën e rendit publik. Kryetari i Bashkisë jo vetëm që drejton takimet e hapura publike dhe mbledhjet e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, por ai kontribuon

në përmirësimin e çdo politike dhe nxit qëndrimin aktiv të bashkisë që nga shërbimet sociale, të arsimit, të ndihmës ekonomike edhe të tjera deri tek ndërlidhësit komunitarë dhe kryesitë e fshatrave. **Bashkia dhe Këshilli Bashkiak** punojnë së bashku për përmirësimin e mbështetjes financiare për infrastrukturën e nevojshme në drejtim të forcimit të sigurisë publike. Institucioni i Bashkisë siguron infrastrukturën mbështetëse për realizimin e aktivitetit të KVSP-ve. **Kryetari i Bashkisë** është autoriteti që frymëzon partneritetin me institucionet e tjera publike apo private në këtë sipërmarrje dhe në mënyrë të veçantë me drejtuesit e institucioneve të “trekëndëshit”.

Si pjesë e trekëndëshit, **strukturat vendore të policisë së shtetit** kanë mundësi konkrete të orientojnë qasjet parandaluese në komunitet dhe të fuqizojnë rolin e punonjësit të policisë në sy të publikut,¹⁵ Për herë të parë Policia e Shtetit ndan punën, “tradicionalisht” të saj, me

14 Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021 – 20226 dhe Plani i Veprimit 2021 – 2023.

15 Shih Strategjinë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021 - 2026

të gjithë aktorët e tjerë, bashkinë, prokurorinë, institucionet e tjera publike dhe private përfshirë shoqërinë civile dhe qytetarët, në përputhje të plotë me Strategjinë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021 - 2026. Plani shumaktorial vendor e dëshmon këtë praktikë të re.

Kjo do të thotë që bashkëpunimin saj në raport me institucionet e tjera të mos e vlerësojë si një aktivitet formal, por si diçka me të cilën mund dhe duhet të ndërtojë punën e vet parandaluese. Në mënyrë proaktive çdo komisariat policie duhet të investojë për një mjedis ku të gjitha institucionet publike dhe jo publike përfshirë edhe qytetarët të ndjejnë përgjegjësinë e bashkëpunimit për parandalimin e çdo kërcënimi për komunitetet. **Shefi i komisaritit** duhet ta shndërrojë planin shumaktorial vendor në një qasje pune konkrete për të gjithë sektorët në komisariat pa përjashtim. Jo vetëm sektori i rendit publik por sektori i krimeve duhet të jetë po aq përgjegjës për parandalimin. Në këtë mënyrë i jepet rëndësia bashkëpunimit, partneritetit me institucionet e tjera, transparencës dhe komunikimit publik, kushte të cilat kërkohen për ndryshimin e qasjes ndaj policimit.

Prokuroria ka qenë shumë mbështetëse në këtë sipërmarrje të gjerë vendore si në raport me institucionet e “trekëndëshit” ashtu dhe me aktorët e tjerë si shkollat, organizatat jo

fitimprurëse etj. Reforma në drejtësi i ka dhënë më shumë vendimmarrje prokurorisë vendore e cila ka rezultuar në një aktivizim më të madh publik të prokurorëve, si një mundësi shumë e mirë për përmirësimin e treguesve të besimit publik. Nga ana tjetër, pjesëmarrja aktive e prokurorisë i jep besueshmëri më të madhe proceseve në kuadër të kësaj qasjeje. Kontributi më i rëndësishëm i prokurorisë mund të jetë:

- » Bashkëpunimi me institucionet arsimore në një hapësirë të gjerë komunikimi që ka të bëjë me edukimin ligjor të të rinjve;
- » Komunikimi publik i statistikave dhe tendencave vendore të veprimtarisë kriminale si mjet informimi dhe parandalimi.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ka pasur një rol aktiv në veprimtarinë e KVSP-së së Bashkisë Elbasan, rol ky që ka ardhur gjithnjë e në rritje.

Sipas Rregullores të KVSP-ve, Prokurori caktoi përfaqësuesin e institucionit në SKN (Sekretariati Koordinues Ndërinstitucional) dhe është marrë pjesë në nivel titullari në të gjithë takimet periodike të KVSP-së së Bashkisë Elbasan, sipas agjendës së miratuar paraprakisht, si dhe në takimet e

Ilogaridhënies publike dhe të transparencës të organizuar nga KVSP-ja. Ndërkohë, në kuadër të planit shumfaktorial ka ndërmarrë edhe nisma për probleme të sigurisë, si takime me drejtuesit e policisë, takime me studentë të Universitetit të Elbasanit dhe nxënës të shkollave të qytetit. Prokuroria ka qënë gjithnjë e gatshme në paraqitjen e të dhënave statistikore të kërkuara nga KVSP-ja për fusha të caktuara që lidhen me sigurinë publike, dhe së fundmi në hartimin dhe plotësimin e databazës me tregues të vlerësimit të performancës të aktiviteteve të ndërmarra nga KVSP-ja në Bashkinë Elbasan.

Nga Prokuroria janë nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit për Mekanizmin e Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje me 6 Bashki të qarkut të Elbasanit, konkretisht bashkitë: Elbasan, Belsh, Gramsh, Peqin, Librazhd dhe Prrenjas.

Prokuroria Elbasan ka lidhur marrëveshje me katër OJF për çështje që lidhen me referimin e rasteve të dhunës në familje, ndihmës së fëmijëve viktimë të krimit apo mbrojtjes së fëmijëve. Përveç këtyre marrëdhënieve me

shoqatat, Prokuroria ka referuar raste të të miturve, viktimë të krimit drejtpërdrejt në drejtorinë e shkollave, me qëllim ofrimin e asistencës psikologjike nga psikologu i shkollës.


Institucionet Arsimore: Angazhimi aktiv i të rinjve luan një rol të rëndësishëm në ndërgjegjësim apo në luftën ndaj fenomeneve negative të krimit, përdorimit të lëndëve narkotike, bullizmit apo ekstremizmit të formave të ndryshme, si dhe masave parandaluese kundrejt kërcënimeve në nivel vendor. Roli i tyre dhe i drejtuesve të zyrave arsimore bëhet parësor gjatë pjesëmarrjes dhe organizimit të takimeve të hapura konsultuese, por edhe më tej në mbledhjet e KVSP-ve. Ndërveprimi i institucioneve arsimore dhe policore si një mundësi partneritetesh dhe besimi reciprok shndërrohet në domosdoshmëri për komunitete të sigurta. Ky ndërveprim mund të conceptualizohet edhe përmes integritetit të aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të programit “Shkolla-Qendër Komunitare” duke shtuar pjesëmarrjen e prokurorisë. Në këtë qasje policia dhe shkolla duhet të shfrytëzojnë sportin si mundësi për ndërtim partneriteti dhe besimi. Edukimi ligjor i nxënësve mbetet shumë i rëndësishëm.

Shoqëria civile, komunitetet fetare, media dhe biznesi: Aktorët e shoqërisë civile mbeten faktorë mjaft të rëndësishëm të proceseve që lidhen me sigurinë publike, jo vetëm si anëtarë të KVSP-ve por mbi të gjitha si aktorë të rëndësishëm pjesëmarrës në hartimin dhe zbatimin e planit shumaktorial vendor për parandalimin e krimit. Organizatat e shoqërisë civile (OSHC), komunitetet dhe udhëheqësit fetarë dhe përfaqësues të tjerë të shoqërisë civile luajnë role kritike dhe të larmishme në zhvillimin e shoqërisë. Komunitetet fetare përfaqësojnë një shembull pozitiv në shoqëri për sa i përket mirëkuptimit, tolerancës dhe bashkëpunimit.

Duke qenë afër dhe në kontakt të drejtpërdrejtë me grupet e marginalizuara, të cënueshme dhe të papërfaqësuar, OSHC-të mund konsiderohen si një ndër partnerët me aktivë dhe dinamikë të KVSP-ve. Roli i shoqërisë civile duhet të evidentohet qartë në planin shumaktorial vendor edhe si një nga aktorët që merr përsipër lehtësimin dhe realizimin e shumë objektivave dhe zbutjen e kërcënimeve të sigurisë. Plani shumaktorial angazhon dhe orienton aktivitete të organizatave të shoqërisë civile, të cilat mund të gjejnë mbështetje financiare nga donatorë të ndryshëm përfshirë edhe nga bashkitë.

Organizatat e shoqërisë civile janë, në shumë raste, pjesa më aktive e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike duke ndërtuar agjendën e tyre në përputhje me objektivat e punës së KVSP-ve. Organizata të ndryshme të grave, të rinjve, bëhen pjesë aktive e agjendës për hartimin dhe zbatimin e planit shumaktorial vendor.

**SHTOJCA 1.
RREGULLORE
E BASHKISË
ELBASAN "PËR
ORGANIZIMIN
DHE
FUNKSIONIMIN
E KËSHILLIT
VENDOR TË
SIGURISË
PUBLIKE"**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1082/11 Prot.

Elbasan, me 24.03.2022

VENDIM
Nr. 22 datë 24.03.2022

Për rikonceptimin e strukturës përbërëse dhe rregullores me VKB, nr.121, datë, 24/10/2016, "Për përbërjen, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyrën e funksionimit të Këshillit Vendor për Siguri Publike"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 04/03/2022, mbështetur në nenin 29 dhe 54 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 11/3 pika d dhe 78/2 i ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 930, datë 18.11.2015, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe planit të veprimit":

VENDOSI

1. Miratimin e strukturës së Këshillit vendor të Sigurisë Publike
2. Miratimin e rregullores së tij "Për përbërjen, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyrën e funksionimit të Këshillit Vendor për Siguri Publike".
3. Miratimin e planit të veprimit.
4. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Konceptoi: Sekretariati Teknik i KVSP-së Kristina Kreka

Dr. Kujdesit social Shefki Lika

Pranoi: Dr. Projekteve Klinisi Lala

Dr. Juridike Arben Hoxha

Miratoi: Koordinatorin KVSP-se Ervin Muco

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Klajd GRIPSHI

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Hektor ÇIFTJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 1082 Prot.

El basan, më 28.02.2022

RREGULLORE

“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT VENDOR PËR
SIGURINË PUBLIKE”

Konteksti

Zhvillimi ekonomik dhe social i vendit lidhet ngushtë me forcimin e sigurisë publike, uljen e kriminalitetit, zbatimin e ligjit, eliminimin e dhunës dhe mbrojtjen e grupeve të cenueshme, luftën ndaj ekstremizmit të dhunshëm, luftën ndaj kultivimit dhe përdorimit të lëndëve narkotike, apo përballjen me çdo fenomen tjetër krimi dhe paligjshmërie.

Komunitetet në nivel vendor në zona urbanë dhe rurale ndeshen me dinamika nga më të ndryshmet që lidhen me zbatimin e ligjit, integritetin e pronës dhe të individit, apo sfida të karakterit ekonomik, social dhe zhvillimor. Një shoqëri e hapur dhe demokratike gjithmonë do të gjendet nën trysinë e kërcënimeve të vazhdueshme të sigurisë të cilat mund të përballën vetëm përmes një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse të gjithë shoqërisë, duke siguruar një bashkëjetesë të qetë dhe kohezion social.

Pikërisht kjo qasje shumë-aktoriale vendore do të ishte një mekanizëm efektiv në përballjen jo vetëm me kërcënimet e lartpërmendura por edhe me dukuri të reja, si përballja e flukseve imigatore, riintegrimi në shoqëri i azilkërkueseve dhe refugjatëve që iu largohen konflikteve të armatosura në vendet e tyre të origjinës. Po kështu, shoqëria jonë dhe komunitetet vendore po përballen me sfidat në kuadër të procesit të riintegritimit dhe rehabilitimit të qëndrueshëm të shtetasve shqiptarë që kthehen nga zonat e konfliktit si Siria dhe Iraku.

Tashmë është e gjithë pranuar se këto sfida qëndrojnë dukshëm përtej kapaciteteve aktuale të institucioneve, përfshirë ato të zbatimit të ligjit, për t'u përballur me sukses pa bashkëpunuar dhe ndarë përgjegjësitë në nivel vendor midis tyre dhe me qytetarët.

Ministria e Brendshme ka mbështetur mirëfunksionimin e Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike në bashki të ndryshme të vendit.

Po kështu, krahas bashkive, edhe Policia e Shtetit, si dhe partnere të ndryshëm ndërkombëtarë dhe kombëtarë, janë investuar për të operacionalizuar këtë model që bën bashkë institucionet vendore, shoqërinë civile, biznesin dhe aktorë të tjerë.

Përvoja të ndryshme në vend, por edhe përvoja ndërkombëtare i kanë shërbyer një procesi reflektimi nga mësimet e nxjerra dhe diktojnë nevojën për permiresimin e funksionimit të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike. Këto ndryshime prekin objektivat dhe strukturën organizative, proceset konsultuese dhe vendimmarrëse, nivelin e përfshirjes qytetare, dhe rolin e institucioneve të ndryshme në këtë proces, të cilat ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e punës së Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike.

Kreu I

Dispozita të Përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe procedurave që zbatohen për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit Vendor të Sigurisë Publike (KVSP) pranë bashkisë.
2. KSVP funksionin si, si një mekanizëm koordinues, identifikues dhe menaxhues pranë bashkisë mbi problematikat që lidhen me sigurinë e komunitetit për çështje të rendit dhe sigurisë publike dhe ushtron veprimtarinë në përputhje me Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
3. Veprimtaria e KVSP mbështetet para së gjithash në partneritetin dhe bashkëpunimin mes Bashkisë, Policisë dhe Prokurorisë dhe ndërveprimit të tyre me aktorët e tjerë publikë dhe jo publikë.

Neni 2

Objekti

1. Objekt i kësaj rregulloreje është veprimtaria e KVSP, Sekretariatit Koordinues Ndërinstitucional dhe Sekretariatit Teknik të tij.
2. Kjo rregullore përcakton:
 - a) rregullat procedurale të cilat zbatohen nga KSVP, gjatë funksionimit, vendimmarrjes dhe mbledhjes së tij, rregullat e shpalljes dhe publikimit të vendimeve;
 - b) rregullat procedurale mbi funksionimin e Sekretariatit Koordinues dhe Sekretariatit Teknik të KVSP;
 - c) marrëdhëniet ndërmjet Këshillit dhe publikun.
3. Kjo rregullore synon të sigurojë partneritet të qëndrueshëm ndërmjet institucioneve të përfshira në KVSP, bashkëpunimin me komunitetin me qëllimin përfundimtar krijimin e një ambienti të sigurt për komunitetin e Bashkisë Elbasan.

Neni 3

Baza rregullatore

1. Aktet kombëtare janë:
 - Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
 - Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 29/1;
 - Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
 - Strategjia Ndërsëktoriale e Sigurisë në Komunitet 2021-2026;
 - Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm;
 - Strategjia Afatmesme e Prokurorisë së Përgjithshme 2018-2020.

2. Aktet ndërkombëtare:

- Deklarata Universale e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

KREU II

Funksionimi I Këshillit Vendor të Sigurisë Publike

Neni 4

Përbërja e KVSP

1. Këshilli Vendor i Sigurisë Publike (KVSP) përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

- a) Kryetari i Bashkisë;
- b) Kryetari i Këshillit Bashkiak;
- c) Drejtues i Komisarariatit të Policisë;
- d) Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor në juridiksionin e së cilës përfshihet bashkia;
- e) Anëtar i Këshillit Bashkiak që siguron përfaqësimin e çdo partie politike në Këshillin bashkiak;
- f) Drejtues i Zyrës Arsimore Vendore;
- g) Drejtues i Drejtorisë Vendore të Shëndetit Publik;
- h) Përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Vendor Social Shtetëror;
- i) Nga një përfaqësues i komuniteteve fetare;
- j) Përfaqësues të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në nivel Vendor;
- k) Përfaqësues të shoqërisë civile (organizata rinore, organizata e grave, media vendore, biznese, shoqata të pakicave kombëtare, etj.);
- l) Drejtues i Emergjencave Civile në bashki dhe qark,
- m) Drejtuesi i Shërbimit Social në bashki;
- n) Përfaqësues nga njësia për mbrojtjen e fëmijëve dhe kundër dhunës në familje;
- o) Drejtues të institucioneve arsimore në bashki.

2. Në mbledhjet e KVSP mund të ftohen të marrin pjesë edhe:

- a) Prefekti i Qarkut;
- b) Kryetari e Gjykatës së juridiksionit të përgjithshëm;
- c) Përfaqësues të institucioneve publike të ndryshme në nivel vendor apo të grupeve të interesit, në varësi të tematikës së mbledhjes.

3. Anëtarët e ftuar në mbledhjet e KVSP angazhohen në format këshillues për shkëmbim informacioni ndër-institucional.

Neni 5

Kryetari i KVSP

1. Kryetari Bashkisë është kryetari i KVSP.

2. Kryetari ushtron përgjegjësitë si më poshtë:

- a) ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar funksionimin efektiv dhe efikas të KVSP;
- b) koordinon dhe mbikëqyr administrimin e të gjitha aktiviteteve të KVSP;
- c) përfaqëson KVSP në marrëdhëniet me të tretët, duke përfshirë dhe bashkëpunimet me

- organizmat ndërkombëtare;
- d) informon Këshillin Bashkiak për veprimtarinë e KVSP së paku një herë në vit.

Neni 6

Përgjegjësitë e KVSP

1. Mbështet dhe inkurajon një partneritet të qëndrueshëm me të gjitha institucionet e përfshira në KVSP me qëllim identifikimin dhe parandalimin e problematikave në kuadër të sigurisë publike.
2. Koordinon, identifikon dhe menaxhon në nivel vendor mbi problematikën që lidhen me sigurinë e komunitetit duke garantuar
3. Sipas rastit, KVSP komunikon me institucionet e qeverisjes qendrore për zbatimin e masave për parandalimin e krimit.
4. Mbështet dhe koordinon me organizatat të shoqërisë civile, komunitetet fetare, komunitetin e biznesit angazhime konkrete në përballjen me sfidat e sigurisë në komunitet me qëllim parandalimin e konflikteve, sjelljeve antishoqërore, si dhe veprimeve të tjera të dhunshme.
5. Realizon dhe vlerëson takimet konsultuese publike me përfaqësues të komuniteteve vendore (sipas pikës 1 të Nenit 8) për të ndërtuar axhendën vendore të sigurisë dhe përditësimin e saj në vazhdimësi.
6. KVSP miraton, zbaton, dhe rishikon planin shumë-aktorial vendor.
7. Planin shumëaktorial për parandalimin dhe luftën ndaj krimit në nivel vendor është një dokument i cili përfshin tërësinë e risqeve të vlerësuara, intensitetin e tyre, si dhe masat përkatëse, institucionet përgjegjëse dhe afatet kohore për realizimin e tyre. Afati i zbatimit të Planit është vjetor dhe përditësohet në vazhdimësi.
8. Institucionet përgjegjëse të përfaqësuara me anëtarë në KVSP do të shkëmbejnë informacione në përputhje me legjislativon në fuqi dhe KVSP do të përdorë informacionin për të lehtësuar marrjen e vendimeve lokale dhe zgjidhjet e problemeve në partneritet.

Neni 7

Mbledhjet e KVSP

1. Mbledhja e KVSP ushtron, por nuk kufizohet në kompetencat e mëposhtme:
 - a) Miraton, vlerëson zbatimin dhe rishikon planin shumë-aktorial vendor;
 - b) Përcakton drejtimit kryesorë të axhendës së sigurisë publike në nivel vendor;
2. Mbledhjet e KVSP mbahen së paku 2 herë në vit. Ato zhvillohen në ambientet e bashkisë, me përjashtim të rastit kur Kryetari vendos ndryshe.
3. Në rastet e ngjarjeve të ndryshme të papritura apo me një ndjeshmëri të veçantë, Kryetari mund të realizojë mbledhje me anëtarësi më të vogël pjesëmarrësish që lidhen drejtpërdrejt me problematikën.
4. Kryetari i KVSP i thërrret dhe i kryeson mbledhjet e KVSP. Ftesa me rendin e ditës dhe materialet për shqyrtim u dërgohen anëtarëve të KVSP së paku 5 ditë para mbledhjes së radhës.
5. KVSP zhvillon punën në bazë të rendit të ditës të miratuar nga kryetari i KVSP.
6. Kryetari i KVSP jep fjalën, drejton debatin dhe përcakton fillimin dhe përfundimin e shqyrtimit të secilës çështje të rendit të ditës.
7. Pas mbylljes së diskutimeve mes tyre, anëtarët e KVSP dakordësojnë vendime/akte me konsensus të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
8. Vendimet/aktet e miratuara në mbledhje nënshkruhen nga kryetari i KVSP. Sekretariati teknik merr mara për t'i shpërndarë një kopje të tij çdo anëtar.

Neni 8
Metodologjia e hartimit dhe monitorimit të zbatimit të planit vjetor shumë-aktorial vendor

1. Plani vjetor shumë-aktorial buron nga komunikimi i hapur publik i drejtuesve të Bashkisë, Policisë dhe Prokurorisë, me grupe interesi dhe qytetare (të tillë si drejtuesit e shkollave të ndryshme, prindërve, qeveritë e nxënësve, kryetarët e fshatrave apo ndërlidhësit komunitarë, përfaqësues të bizneseve vendore, shoqërisë civile dhe medias).
2. Sekretariati Koordinues (neni 9) vlerëson intensitetin e risqeve (të lartë, të moderuar dhe të ulët), orienton llojin e aktivitetit dhe institucionet përgjegjëse. Prioritetet dhe intensiteti i risqeve të sigurisë të prezantuara nga qytetarët përbejnë boshtin e planit shumë-aktorial vendor.
3. Plani i veprimit përmban një kalendar aktivitetesh dhe afatesh për organizimin e tyre të cilat synojnë adresimin e risqeve të vlerësuara.
4. Plani shumë aktorial vendor diskutohet dhe miratohet në mbledhjen e radhës të KVSP.
5. Monitorimi i planit vjetor shumë-aktorial realizohet nga drejtues të Bashkisë, Policisë dhe Prokurorisë, përmes takimeve konsultuese të hapura me komunitetin një herë në 6 muaj. Në këto takime publike konsultuese analizohet ecuria e zbatimit të planit shumë aktorial dhe identifikohen nevojat për përditësimin e tij. Rishikimi i planit vjetor shumë –aktorial me objektiva apo masa të reja mbështetur në nevojat e identifikuar miratohet nga mbledhja e KVSP.
6. Një format tip i raportit të monitorimit të zbatimit të planit shumë-aktorial vendor hartohet nga sekretariati teknik dhe ai koordinues dhe miratohet nga kryetari i KVSP.

Neni 9
Sekretariati koordinues Ndërinstitucional

1. Pranë KVSP funksionon sekretariati koordinues. Ky sekretariat ndjek zbatimin e planit shumë-aktorial vjetor.
2. Sekretariati mblidhet periodikisht (së paku një herë në muaj) për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve dhe masave të planit.
3. Sekretariati koordinues përbëhet nga tre anëtarë përkatësisht: një përfaqësues i Bashkisë, Policisë dhe Prokurorisë të caktuar nga titullarët e institucioneve përkatëse.
4. Sekretariati koordinues raporton tek drejtuesit e institucioneve që ata përfaqësojnë mbi gjetjet nga procesi i monitorimit të zbatimit të planit vjetor shumë-aktorial.
5. Sekretariati koordinues dakordëson axhendën e takimeve konsultuese publike dhe mbledhjeve të KVSP para mbajtjes së tyre.
6. Sekretariati koordinues merr pjesë në mbledhjet e KVSP.

Neni 10
Sekretari teknik i KVSP

1. KVSP cakton sekretarin teknik të KVSP i cili është një punonjës i bashkisë.

2. Sekretari teknik, në bashkërendim të ngushtë me kryetarin e KVSP, kryen detyrat si më poshtë:
 - a) harton procesverbalet e mbledhjes, shkresat apo aktet e ndryshme të KVSP, mbajtjen e arkivës dhe protokollit të KVSP;
 - b) protokollon procesverbalet e mbledhjes;
 - c) koordinon me drejtorinë e Inovacionit Teknologjise dhe Medias, me Sektorin e mediave per arshivimin e rregjistrimit zanor te plote te takimit te mbajtur;
 - d) dërgon dhe ndjek njoftimet dhe veprime të tjera të sekretarisë;
 - e) përgatit materialin, rekomandimet apo vendimet e marra pas çdo takimi të KVSP;
 - f) mban listë-prezencën e anëtarëve të pranishëm të KVSP dhe personave të tjerë të pranishëm në mbledhje;
 - g) koordinon me sektorin e mediave për përgatitjen e njoftimeve për publikim;
 - h) koordinon me sektorin e IT-së për publikimin e njoftimeve apo materialeve që do të publikohen;
 - i) kryen veprimet për publikimin e njoftimeve dhe akteve në faqen zyrtare të bashkisë apo në media duke koordinuar punën me koordinatorin për informim dhe njoftimet publike.
 - j) krijon kushtet e përshtatshme për zhvillimin e mbledhjeve dhe veprimtarive të KVSP.
3. Sekretari teknik merr pjesë në mbledhjet e KVSP.
4. Merr pjesë në takimet e sekretariatit koordinues.

Kreu III Transparenca dhe komunikimi me publikun

Neni 11 Komunikimi me publikun

1. KVSP komunikon me publikun pas çdo mbledhjeje përmes një komunikate për mediat, e cila, sipas natyrës së çështjeve të trajtuara, informon së paku për: a) kohën e mbledhjes; b) pjesëmarrjen; c) çështjet e shqyrtuara në rendin e ditës; ç) thelbin e diskutimeve të KVSP.
2. Njoftimi për publikun përgatitet nga sekretari teknik në bashkëpunim me sekretariatin koordinues të KVSP.
3. Kryetari i KVSP urdhëron publikimin e njoftimit brenda 3 ditë/pune nga zhvillimi i mbledhjes.

KREU IV DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 12 Dispozitë kalimtare

Ndryshimet dhe shtesat në këtë rregullore do të bëhen sipas procedurës së nxjerrjes së saj.

Neni 13 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi me miratimin nga mbledhja e Këshillit Bashkiak dhe publikohet në faqen zyrtare të bashkisë.

SHTOJCA 2: QENDRA E KOORDINIMIT KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM NË SHQIPËRI

Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri ka një rol të rëndësishëm në koordinimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të aktorëve lokalë dhe praktikuesve të vijës së parë të përfshirë në çështjet e sigurisë që lidhen specifikisht me përpjekjet për të luftuar kërcënimet nga ekstremizmi i dhunshëm.

Qëllimet e Qendrës janë:

- » Forcimi i koordinimit, bashkëpunimit dhe partneritetit në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, ndërmjet agjencive qeveritare, organizatave joqeveritare, sektorit privat, komuniteteve fetare dhe mediave, në identifikimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve efektive;
- » Inkurajimi i hulumtimit vendor si mjet për të kuptuar kushtet, faktorët dhe shkaqet që nxisin radikalizimin që mund të kalojë në dhunë dhe qëndresën e komunitetit ndaj ekstremizmit të dhunshëm;
- » Forcimi i qëndresës së komunitetit dhe zvogëlimi i tërheqjes ndaj radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet programeve dhe politikave të arsimit, punësimit dhe parandalimit nga policia në komunitet;
- » Koordinimi i përpjekjeve të programeve të riintegritimit për ish të dënuarit për krime që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm;
- » Ulja e ndikimit të propagandës ekstremiste në rrjetet sociale dhe rekrutimit në internet, duke shfrytëzuar mediat sociale si kanale të komunikimit për të promovuar narrativa alternative dhe mesazhe pozitive.
- » Qendra QKEDH synon të bashkëpunojë me aktorët e sektorit publik dhe privat për të ruajtur dhe promovuar vlerat e tolerancës dhe harmonisë fetare, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sundimin e ligjit dhe demokracinë, si dhe ruajtjen e shoqërisë shqiptare nga ekstremizmi i dhunshëm .

